



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "ALBPETROL" SHA

Nr. 3659 Prot.

Patos, më 21.06. 2024

URDHËR

Nr. 208, datë 21.06.2024

PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË SË MENAXHIMIT TË RISKUT TË SHOQËRISË
"ALBPETROL" SH.A

Në mbështetje të Kodit të Procedurave Administrative, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, dhe Statutit të shoqërisë "Albpetrol" SH.A,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të shoqërisë "Albpetrol" Sh.A, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Strategjia e Menaxhimit të Riskut të shoqërisë "Albpetrol" SH.A të monitorohet çdo vit nga strukturat përgjegjëse dhe ecuria e implemtimit të saj të raportohet në mënyrë periodike në raportet e analizës që kryen shoqëria "Albpetrol" SH.A.
3. Strategjia e Menaxhimit të Riskut të publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë "Albpetrol" Sh.A, www.albpetrol.al, në rubrikën "Programi i Transparencës".
4. Ngarkohen drejtoritë e shoqërisë "Albpetrol" Sh.A për monitorimin, ndjekjen dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të shoqërisë "Albpetrol" Sh.A.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATOR

Eltar DEDA



Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia Rr. "Fier-Patos", Km. 7, Patos
T +3553813662 F +35534704415 www.albpetrol.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA

STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RISKUT

SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A

MAJ, 2024



Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia Rr. “Fier-Patos”, Km. 7, Patos
T +3553813662 F +35534704415 www.albpetrol.al

PËRMBAJTJA:

Nr.	Emërtimi	Fq.
I	HYRJE	3
II	BAZA LIGJORE	3
III	PËRKUFIZIME DHE PËRCAKTIME	5
IV	DEKLARATA E POLITIKËS SË MENAXHIMIT RISKUT	5
V	QËLLIMI I POLITIKËS SË MENAXHIMIT RISKUT	6
VI	PARIMET DHE KOMPONENTËT E MENAXHIMIT TË RISKUT	6
1.	Ambienti i kontrollit	7
2.	Vendosja e objektivave	7
3.	Identifikimi dhe dokumentimi i riskut	7
4.	Analiza dhe vlerësimi i riskut	8
5.	Adresimi dhe përgjigjia ndaj riskut	9
6.	Veprimtaritë e kontrollit	10
7.	Informimi dhe komunikimi	11
8.	Monitorimi dhe raportimi i riskut	12
VII	PLANI I MENAXHIMIT TË RISKUT	12
1.	Skema e menaxhimit të riskut	12
2.	Roli dhe Përgjegjësitë	13
3.	Regjistri i riskut	13
4.	Lista e risqeve prioritare të “Albpetrol” Sh.A	14
VIII	PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË	15

I. HYRJJE

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut dhe është ndërtuar si pjesë e pandarë me Strategjinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për shoqërinë “Albpetrol” Sh.A, duke menaxhuar risqet në vendimmarrje, vendosjen dhe arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës në aktivitetin operacional dhe prodhues të naftës bruto, si dhe në shërbimet mbështetëse që ofron.

Dokumenti përcakton standartet që duhen përdorur në procesin e kontrollit të aktivitetit administrativ, operacional dhe prodhues me qëllim që të arrihet një përdorim më eficient i burimeve dhe rezultate sa më optimale në kontrollin e zbatimit të kuadrit ligjor të menaxhimit financiar.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi (Drejtori dhe Qendër) në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdijshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Menaxhimi i riskut është pjesë e drejtimit dhe është thelbësor për mënyrën se si shoqëria “Albpetrol” Sh.A, menaxhohet në të gjitha nivelet. Menaxhimi i riskut është faktor kontribues në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit duke qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve që lidhen me një institucion dhe përfshin ndërveprimin me palët e interesuara.

Gjithashtu, ky proces merr në konsideratë kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, si dhe menaxhimi i riskut bazohet në parimet, kuadrin dhe procesin e përshkruar në këtë dokument.

Këta elementë mund të jenë prezentë tashmë plotësisht ose pjesërisht në sistemin e punës së shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, megjithatë, ata kanë nevojë të përshtaten ose përmirësohen në mënyrë që menaxhimi i riskut të jetë i unifikuar, efikas dhe efektiv dhe në përputhje me objektivat strategjike të saj.

II. BAZA LIGJORE

Parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe

përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin përcaktohen në Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", të ndryshuar.

Gjithashtu, në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik për shoqërinë "Albpetrol" Sh.A janë marrë në konsideratë:

1. Praktikrat më të mira ndërkombëtare si Standardi ISO 31000:2018 për Administrimin e Riskut.
2. Dokumentet strategjike si programe, manuale, kode, rregullore të hartuara dhe miratuara në shoqërinë "Albpetrol" Sh.A:
 - Programi i Zhvillimit Ekonomik për vitin ushtrimor
 - Statuti i shoqërisë "Albpetrol" Sh.A
 - Rregullore e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë "Albpetrol" Sh.A
 - Kodi i Etikës
 - Kontrata Kolektive e Punës e lidhur me Sindikatat e punonjësve
 - Marrëveshjet Hidrokarbure që shoqëria "Albpetrol" Sh.A, është palë
3. Legjislacioni shqiptar për shoqëritë tregtare, por pa u kufizuar:
 - Vendimi nr. 848, i Këshillit të Ministrave, datë 07.12.2016, "*Për krijimin e Shoqërisë "Albgaz" Sh.A, dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë "Albpetrol" Sh.A dhe "Albgaz" Sh.A*", të ndryshuar;
 - Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008, "*Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare*",
 - Ligji Nr.7746, datë 28.7.1993, "*Për Hidrokarburet*" (Kërkimi dhe prodhimi),
 - Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995, "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" (i ndryshuar),
 - Ligji Nr.9367, datë 7.4.2005; "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*",
 - Ligji Nr.119/2014, datë 18.09.2014, "*Për të drejtën e informimit*",
 - Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*",
 - Ligji Nr. 10 221, datë 4.2.2010, "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*",
 - Ligji Nr.9154, datë 06.11.2003, "*Për Arkivat*",
 - Ligji Nr.8503, datë 30.6.1999, "*Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare*",
 - Urdhri Nr.83, datë 10.2.2012, "*Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure*", i ndryshuar,
 - Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 8980, datë 15/07/2010, "*Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin*".
 - Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

III. PËRKUFIZIME DHE PËRCAKTIME

- **"Risku"** - është efekti i pasigurisë në arritjen e objektivave dhe mund të shoqërohet me pasoja të cilat mund të jenë avantazhuese ose dizavantazhuese në varësi të situatës apo ngjarjes.
- **"Vlerësim i Riskut"** - procesi i krahasimit të rezultateve të analizës së riskut me kriteret e riskut, për të përcaktuar nëse risku dhe/ose madhësia e tij, janë të pranueshëm, ose të tolerueshëm.
- **"Zotëruesi i Riskut"** - është personi brenda një njësie organizative, i cili ka autoritetin dhe është përgjegjës për administrimin e riskut, brenda njësisë së tij.
- **"Politikë"** - jep parimet bazë që udhëheqin institucionin, për çështje apo situata e ngjarje specifike. Këto parime përdoren si guidë gjatë vendim-marrjeve të caktuara.
- **"Probabiliteti"** - është shansi që diçka mund të ndodhë. Ai mund të përcaktohet, vendoset apo matet në mënyrë objektive, ose subjektive, dhe mund të shprehet ose në mënyrë cilësore, ose sasiore (duke përdorur modele matematikore).
- **"Palë e Interesuar"** - një person apo një organizatë që mund të ndikojë apo mund të ndikohet nga një vendim apo një aktivitet.
- **"Risk i Mbetur"** - është Risku që mbetet pasi ke implementuar një mënyrë të trajtimit/adresimit të tij, ke eliminuar/neutralizuar burimin e Riskut, modifikuar pasojat e Riskut, ke ndryshuar probabilitetin, ke transferuar ose ke mbajtur Riskun.
- **"Risku i qënësishëm/i pandashëm"** - në standartet ndërkombëtare ISO 31000, risk i qënësishëm i referohet kryesisht në kontekstin kontabël materializimit të një risku për të cilin nuk ka ose nuk mund të ndërtohen sisteme kontrolli.
- **"Strategji risku"** - Strategjia e riskut përshkruan strukturën organizative të institucionit, planin e zhvillimit strategjik dhe atë të rritjes së aktivitetit të shoqërisë "Albpetrol" Sh.A, në prespektivë. Ajo përcakton politika specifike të menaxhimit të riskut, vendos një kuptim të përbashkët të të gjitha hallkave drejtuese në lidhje me objektivat e menaxhimit të riskut që do të thotë është një guidë bazë për menaxhimin dhe kontrollin e riskut në shoqërinë "Albpetrol" Sh.A,. Këto politika përkufizojnë profilin e riskut që "Albpetrol" Sh.A, merr përgjithësisht (ose shmang) dhe shpjegojnë nivelin e "synuar" të tij të shprehur dhe në buxhet në formën e nivelit të provigjioneve të planifikuara, nivelit të fitimit të parashikuar etj.
- **"Vlerësimi i riskut"** - është analiza në lidhje me nivelin e efektit në vlerë që ka çdo tip risku në performancën e "Albpetrol" Sh.A, dhe nëse ky efekt është material apo jomaterial.
- **"Metodologjia e menaxhimit të riskut"** - Përcakton format dhe nivelin e teknikave të kontrollit dhe menaxhimit për çdo tip risku.

IV. DEKLARATA E POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT

Shoqëria "Albpetrol" Sh.A nëpërmjet kësaj Strategjie angazhohet të sigurojë që rreziqet identifikohen dhe trajtohen në kohën e duhur. Politika e shoqërisë "Albpetrol" Sh.A i trajton risqet në lidhje me njëri-tjetrin nën konceptin që menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një tjetër duke siguruar që veprimet e ndërmarra të sigurojnë efektivitet dhe rezultatet e pritshme të arrihen.

Strategjia është ndërtuar mbështetur në disa parime thelbësore që përcaktojnë dhe qëndrimin e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A ndaj menaxhimit të riskut, të cilat janë:

- Menaxhimi i riskut është pjesë integrale e proceseve të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A.
- Menaxhimi i riskut merr në konsideratë faktorët njerëzorë dhe kulturorë.
- Menaxhimi i riskut bazohet në informacionin më të saktë të mundshëm.
- Menaxhimi i riskut është pjesë e vendimmarrjes në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A.
- Menaxhimi i riskut i adresohet pasigurisë.
- Menaxhimi i riskut është sistematik, i strukturuar dhe në kohë.
- Menaxhimi i riskut është transparent dhe gjithëpërfshirës.

V. QËLLIMI I POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT

Qëllimi i politikës së menaxhimit të riskut është identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i tij dhe më tej eliminimi apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot shoqërore dhe financiare në minimumin e domosdoshëm.

Qëllimi i menaxhimit të riskut është të sigurojë që shoqëria “Albpetrol” Sh.A të:

- ketë një proces efektiv për të mbështetur vendimmarrje më të mirë, bazuar në vlerësime realiste të rezultateve,
- të sigurojë në mënyrë të arsyeshme se objektivat e arritura do të arrihen,
- të planifikojë dhe menaxhojë efektivisht burimet në dispozicion,
- të prioritarizojë veprimet për t’u ndërmarrë,
- të rrisë besimin tek sistemi i menaxhimit,
- të zhvillojë një kulturë pozitive institucionale e mbështetëse.

Përmbushja e qëllimeve të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut realizohet nëpërmjet: 1) njohjes së të gjithë punonjësve dhe, në veçanti, menaxherëve të institucionit, me konceptet e riskut; 2) theksimit të domosdoshmërisë së vlerësimit të riskut dhe ndërgjegjësimit të menaxherëve për përgjegjësinë që ata kanë në aplikimin e menaxhimit të riskut, për t’a mbajtur atë në nivele jodëmtuese; 3) promovimit të menaxhimit të riskut si një mjet menaxhimi, ditë pas dite, që, ndër të tjera, siguron menaxhim financiar efektiv, shfrytëzimin optimal të burimeve dhe shmangien e korrupsionit; 4) monitorimit të qëndrueshëm të fushave të riskut; 5) ndërmarrjes së masave për eliminimin apo pakësimin e riskut në nivelin e pranueshëm.

VI. PARIMET DHE KOMPONENTËT E MENAXHIMIT TË RISKUT

Sfida kryesore në menaxhimin e riskut është identifikimi fillestar i riskut, analiza e tij dhe zhvillimi i procesit të menaxhimit të riskut, rishikimet e vazhdueshme dhe përmirësimi në vijimësi i menaxhimit të riskut.

Menaxhimi i riskut në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A, mbështetet në disa parime dhe përbëhet nga disa komponentë, të cilët ndërthuren ndërmjet tyre dhe janë:

4.1 Ambienti i kontrollit

***Ambienti i kontrollit** – Tregon se si risku vlerësohet dhe adresohet në këtë shoqëri tregtare. Ai përfshin filozofinë e menaxhimit të riskut, integritetin dhe vlerat etike, si dhe ambientin e ushtrimit të veprimtarisë.*

Shoqëria “Albpetrol” Sh.A, është shoqëri tregtare që funksionon me 2 (dy) nivele drejtimi, ku së pari Këshilli Mbikqyrës demonstron pavarësi në ushtrimin e detyrave të tij dhe ushtron mbikëqyrje për zhvillimin dhe performancën e kontrollit të brendshëm. Ndërsa Administratori duhet të krijojë një strukturë organizative, të caktojë përgjegjësi dhe të delegojë përgjegjësitë përkatëse për të arritur objektivat e kompanisë, duke mirëpërcaktuar gjithashtu edhe linjat e raportimit. Në vijim, shoqëria “Albpetrol” Sh.A, duhet të ketë personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësisë në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe, më konkretisht, në ndjekjen e objektivave të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A.

4.2 Vendosja e objektivave

***Vendosja e objektivave** – Shoqërohet me analizën e risqeve, si ngjarje që do të kërcënonin realizimin e tyre. Menaxhimi i riskut trajtohet si një proces që zhvillohet mbi bazën e një procedure dhe metodologjie të paracaktuar, që shoqëron hap pas hapi realizimin e objektivave.*

Shoqëria “Albpetrol” Sh.A përcakton objektivat strategjike, programore dhe operacionale, të cilat janë baza mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Administratori i grupon ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e kompanisë, në lidhje me aktivitetet, raportimet dhe pajtueshmërinë.

4.3 Identifikimi dhe dokumentimi i riskut

***Identifikimi i riskut** – Procesi i njohjes, përshkrimit të riskut dhe faktorëve të brendshëm apo të jashtëm, që shkaktojnë këtë risk.*

Shoqëria “Albpetrol” Sh.A identifikon (gjen, njeh dhe përshkruan) risqet që mund të ndikojnë në

arritjen e objektivave të saj në të gjithë kompaninë dhe analizon risqet (shkaqet dhe pasojat e mundshme), si bazë për të përcaktuar më pas se si duhet të menaxhohen risqet.

Duhet të identifikohet risku që vjen **nga burime të jashtme**, ku përfshihen kushtet ekonomike dhe politike, dispozitat ligjore dhe rregullatore, kushtet ambientale dhe ngjarjet natyrore, furnitorët e ndryshëm etj. Gjithashtu, risqet që vijnë **nga burime të brendshme**, ku përfshihen burimet njerëzore, financa dhe çështjet buxhetore, marrëdhëniet e punës, sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe siguria e të dhënave.

Gjatë identifikimit të risqeve duhet të bëhet dallimi midis riskut ekzistues dhe riskut të mbetur.

- **Risku ekzistues** është ekspozimi ndaj një risku specifik, para ndërmarrjes së veprimeve për menaxhimin e tij.
- **Risku i mbetur** është ekspozimi ndaj një risku specifik, pas ndërmarrjes së veprimeve për menaxhimin e tij dhe supozimit se veprimi i ndërmarrë ka qenë efektiv.

Për të gjitha risqet e identifikuara do të caktohen zotëruesit përkatës, të cilët kanë përgjegjësinë e menaxhimit dhe monitorimit të risqeve gjatë gjithë kohës. Zotëruesi i riskut, në përputhje me përgjegjësitë për menaxhimin e tij, duhet të ketë autoritetin e mjaftueshëm për të siguruar që risku menaxhihet në mënyrë efektive.

Risku i identifikuar duhet të dokumentohet në Regjistrin e Riskut, formati i të cilit është i standartizuar dhe pjesë përbërëse e kësaj strategjie. Regjistri i Riskut duhet të publikohet dhe të jetë i disponueshëm për të gjithë stafin e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A.

4.4 Vlerësimi dhe analiza e riskut

Vlerësimi i riskut – Risqet menaxhohen duke analizuar mundësinë e ndodhjes dhe impaktin. Ato vlerësohen duke u nisur nga niveli i efektit negativ dhe mund të jenë me efekt të ulët, të mesëm dhe të lartë.

Procesi i analizimit dhe vlerësimit të riskut është një gjykim që mbështetet në ekspertizën dhe përvojën e vlerësimit të riskut dhe nivelin e informacionit në dispozicion në kohën e shqyrtimit. Risku duhet të analizohet dhe vlerësohet, si dhe të ketë përparësi në lidhje me objektivat e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, të përcaktuara në zbatim të strategjive sektoriale dhe të lidhura ngushtë me procesin e buxhetimit afatmësëm.

Drejtuesit e të gjitha niveleve në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A, duhet të vlerësojnë secilin nga risqet e identifikuara në drejtim të mundësisë së ndodhjes dhe të ndikimit mbi objektivat, përsa vijon:

- a. **Mundësia që risku të ndodhë**, lidhet me probabilitetin/gjasat që një ngjarje e pafavorshme të ndodhë, nëse nuk ka aktivitete kontrolli që do ta parandalonin ose do të pakësonin riskun, apo kur aktivitetet nuk janë të mjaftueshme.

Mundësia që risku të ndodhë duhet të vlerësohet për secilin nga risqet e identifikuara me 3 (tre) shkallë, përkatësisht “i lartë/i mesëm/i ulët”.

- b. **Ndikimi** është efekti që një ngjarje e pafavorshme/padëshirueshme do të kishte në kompani, nëse ngjarja do të ndodhte vërtet. Një efekt i tillë do të ishte ose një lloj dëmi, ose një lloj shansi i humbur. Nëse është e mundur, efekti duhet të përlllogaritet në formë sasiore. Minimalisht, efekti duhet të përshkruhet në mënyrë aq konkrete, sa të tregojë rëndësinë e riskut.

Ndikimi duhet të vlerësohet me 3 (tre) shkallë, përkatësisht “i lartë/i mesëm/i ulët”.

- c. **Vlerësimi i secilit risk**, duhet të shqyrtohet të paktën 1 (një) herë në vit, por edhe më shpesh, në varësi të ndikimit që ka në realizimin e objektivave.

Gjatë vlerësimit të riskut duhet marrë në konsideratë raporti i kostos për aktivitetet e kontrollit që do të ndërmerren ndaj përfitimeve, lidhur me reduktimin e riskut.

Mundësia e ndodhjes dhe impakti që sjell si pasojë çdo risk i identifikuar shpjegohet në Matricën e riskut si më poshtë:

Mundësia e ndodhjes	E lartë			
	E mesme			
	E ulët			
		E ulët	E mesme	E lartë
Ndikimi				

Risqet me prioritet të lartë duhet të ndiqen me vëmendje rregullisht nga Grupi i Menaxhimit Strategjik të Riskut i shoqërisë “Albpetrol” Sh.A.

4.5 Adresimi dhe përgjigjia ndaj riskut

Adresimi i riskut – Kur risqet ndodhin, ka një tërësi mundësish për të reaguar. Risku mund të zvogëlohet ose të kufizohet nëpërmjet kontrolleve parandaluese, korrigjuese, udhëzuese ose zbuluese.

Përgjigjia/reagimi ndaj riskut do të thotë marrja e masave për të ulur mundësinë e ndodhjes dhe ndikimit të riskut deri në bërjen e tij 0 (zero). Në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A, kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, nga Administratori duhet të ndërmerren veprimet korrigjuese dhe t’i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur.

Mundësitë e përgjigjes ndaj riskut janë si më poshtë:

1. Tolerimi/pranimi. Në disa raste, ekspozimi ndaj riskut mund të jetë i pranueshëm dhe në këtë rast nuk parashikohet të ndërmerret ndonjë veprim i mëtejshëm. Përgjithësisht janë risqe, të cilat kanë mundësi të ulët për të ndodhur dhe njëkohësisht kanë impakt të ulët në arritjen e objektivave të punës së shoqërisë “Albpetrol” Sh.A., edhe nëse ndodhin.

2. Trajtimi/reagimi, vendosja e kontrolleve. Qëllimi i trajtimit të risqeve është procesi i vazhdueshëm i identifikimit dhe i vlerësimit të riskut, por njëkohësisht dhe reagimi/përgjigjja ndaj tij, duke ndërmarrë aktivitetet, masat e nevojshme të kontrolleve për të mbajtur riskun në një nivel të pranueshëm.
3. Transferimi. Për disa risqe, përgjigjja/reagimi më i mirë është transferimi i tyre. Ky opsion është veçanërisht i mirë për të zbutur risqet financiare ose risqet e aseteve. Transferimi i riskut mund të konsiderohet, si për të zvogëluar ekspozimin e institucionit, por njëkohësisht dhe për rritur efektivitetin e menaxhimit të risqeve. Megjithatë, dhe nëse kjo është zgjedhur si përgjigje ndaj riskut, shoqëria “Albpetrol” Sh.A, ka si detyrë që marrëdhënia me palën e tretë, së cilës i është transferuar risku, të menaxhohet me kujdes për të siguruar transferimin e suksesshëm të riskut.
4. Përfundimi/Mbyllja. Kur risqet janë shumë të mëdha dhe mund të ndikojnë ndjeshëm në rezultatet e pritshme, mund të anashkalohen, duke hequr dorë përfundimisht nga objektivat, të cilat këto risqe shoqërojnë. Përgjithësisht, risqet e identifikuara janë vlerësuar të menaxhueshme dhe për to janë vendosur kontrollet përkatëse.

4.6 Veprimtaritë e kontrollit

Veprimtaritë e kontrollit – Kur risqet ndodhin, përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Shoqëria “Albpetrol” Sh.A, përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit (rregullat, procedurat dhe veprimet) që kontribuojnë në zbutjen e risqeve për arritjen e objektivave në nivele të pranueshme. Për shkak të shumëllojshmërisë të risqeve dhe reagimi ndaj tyre përfshin një numër të konsiderueshëm procedurash apo kontrollesh si përgjigje ndaj tyre, por standardet përcaktojnë si më të zakonshmen trajtimin e riskut nëpërmjet kontrolleve/procedurave të mëposhtme:

- Kontrollet parandaluese - Kontrolle parandaluese të krijuara për të minimizuar mundësinë e riskut që po ndodh (si ndarja e detyrave, autorizimi dhe miratimi etj.).

Këto kontrolle kufizojnë mundësinë e një rezultati të padëshiruar. Kontrollet parandaluese përfshijnë ndarjen e detyrave, kufizimin e veprimeve të personave të autorizuar (p.sh vetëm ata që janë trajnuar dhe autorizuar lejohen të kryejnë veprimtari të caktuara). Synimi i tyre është parandalimi i ndodhjes së riskut përkatës dhe rritja e sigurisë se objektivat do të arrihen. Hartimi, miratimi dhe vënja në zbatim e rregullores së brendshme të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A., urdhrat dhe udhëzimet janë kontrolle që “Albpetrol” Sh.A, ka ndërmarrë për të reaguar ndaj risqeve të vlerësuara dhe kanë karakter paraveprues/para faktit.

- Kontrollet korrigjuese - Kontrolle korrigjuese të krijuara për të korrigjuar rezultatet e padëshirueshme (si rikuperim i pagesave të pasakta).

Ato sigurojnë një rrugëdaljeje për të arritur njëfarë rikuperimi kundrejt humbjes apo dëmtimit. Këto lloj kontrollesh janë parashikuar të zbatohen për të siguruar zbatimin e detyrimeve, është formë korrigjuese, pasi lehtëson rikuperimin financiar kundrejt një risku që ka ndodhur.

- Kontrollet udhëzuese - Kontrolle drejtuese të krijuara për të siguruar se një rezultat i veçantë është arritur (si masat e sigurisë).

Këto kontrolle sigurojnë arritjen e një rezultati të veçantë tepër specifik, siç janë rregullat e sigurisë, dhe janë të lidhura ngushtë me objektiva të pajtueshmërisë.

- Kontrollet zbuluese - Kontrolle zbuluese, të krijuara për të identifikuar kur rezultate të padëshiruara kanë ndodhur (si kontrollet e magazinës apo aktiveve, ose procesi i rakordimit dhe i inventarizimit, verifikimi i ruajtjes së privatësisë së të dhënave dhe respektimi i afateve të njoftimit dhe publikimit etj.).

Këto kontrolle vendosen për të identifikuar rezultatet e padëshiruara pasi ngjarja ka ndodhur (pra, risku është bërë efektiv). Në dallim nga kontrollet parandaluese, efekti i tyre është “pas ngjarjes” dhe kanë si qëllim krijimin e një efekti parandalues për të ardhmen. Shembuj të kontrolleve zbuluese përfshijnë kontrollin/inventarizimin periodik të materialeve ose aktiveve (ku zbulohen lëvizje të paautorizuara), “rishikime pas zbatimit”, nga të cilat “nxirren mësimet” për të ardhmen gjatë aplikimeve për aktivitete të reja dhe monitorimi i aktiviteteve, ku zbulohen ndryshimet, të cilat kërkojnë zgjidhje. Kryerja e inventarizimeve sipas përcaktimeve të standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar, rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe udhëzimeve për menaxhimin e aktiveve janë kontrolle që shoqëria “Albpetrol” Sh.A, zbaton dhe do të zbatojë për këtë kategori kontrollesh.

4.7 Informimi dhe komunikimi

Informimi dhe komunikimi – Kur risqet ndodhin, merr ose gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm dhe cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Shoqëria “Albpetrol” Sh.A, komunikon me palët e jashtme lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe komunikon në mënyrë të brendshme informacionin e nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm, të cilat janë:

- A. Të dhënat për vitet paraardhëse, të cilat n’a japin njoftime/indikacione të hershme mbi ngjarjet e mundshme që kërkojnë t’u kushtohet vëmendje.
- B. Të dhënat aktuale për një pamje reale të risqeve ekzistuese brenda gjithë institucionit dhe për çdo strukturë që identifikojnë ndryshimet apo devijimet nga pritshmëritë.
- C. Të dhënat për të ardhmen, trendi, të cilat ndihmojnë për të identifikuar dhe vlerësuar risqet e mundshme dhe impaktin e tyre për një periudhë të ardhshme, por që janë të lidhura ngushtë me dy grupet e mësipërme të të dhënave.

4.8 Monitorimi dhe raportimi i riskut

***Monitorimi** - Kur risqet ndodhin, përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe komunikon mangësitë.*

Monitorimi dhe raportimi në vazhdimësi ndihmon të shihet nëse risqet janë menaxhuar me sukses, d.m.th nëse aktivitetet e kontrollit uin realisht risqet përkatëse dhe nëse objektivat e rrezikuara prej këtyre risqeve janë përmbushur. Gjithashtu, vë në dukje nëse risqet janë zmadhuar apo zvogëluar.

Në këtë mënyrë sigurohet transparenca dhe llogaridhënia për veprimtarinë e shoqërisë "Albpetrol" Sh.A, dhe raportet e rregulltra mbi statusin e risqeve, si dhe i jep mundësi drejtuesve të shoqërisë "Albpetrol" Sh.A, të vendosin përparësitë në reagimin ndaj risqeve.

Të gjitha aspektet e procesit të menaxhimit të riskut rishikohen të paktën 1 (një) herë në vit.

VII. PLANI I MENAXHIMIT TË RISKUT

7.1. Skema e menaxhimit të riskut

Në hartimin e dokumentit të strategjisë së menaxhimit të riskut për shoqërinë "Albpetrol" Sh.A, është ndjekur procedura dhe metodologjia si më poshtë:

1. **Krijimi i një ekipi të caktuar**, i cili do të marrë në konsideratë të gjitha operacionet dhe aktivitetet e kompanisë në lidhje me objektivat e saj dhe për të identifikuar risqet që i shoqërojnë ato.
2. **Vetë-vlerësimi i riskut**, ku çdo strukturë e kompanisë kontribon në **identifikimin e risqeve** me të cilat ballafaqohet.

Skema e menaxhimit të riskut paraqet hapat që do të ndiqen:



7.2. Roli dhe përgjegjësitë

Menaxhimi i riskut institucional kryhet nga i gjithë stafi i shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, nga niveli teknik deri në nivel drejtues. Ai është i lidhur ngushtë me veprimtarinë e gjithsecilit. Çdo punonjës duhet të kuptojë rolin e tij në kuadrin e objektivave institucionale brenda funksionit që ata kanë. Çdo punonjës duhet të njohë përgjegjësitë dhe kufizimet e autoritetit të tij.

Strukturat e menaxhimit të riskut janë:

Titullari (Administratori) është përgjegjës për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e Strategjisë për Menaxhimin e Riskeve brenda kompanisë, si dhe për aprovimin e nivelit të tolerimit të riskut.

Grupi i Menaxhimit Strategjik vepron si strukturë, ku diskutohen dhe merren masa mbi çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në kuadrin e menaxhimit të riskut. Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të verifikojë si janë menaxhuar risqet mbi një raport të përgatitur vjetor lidhur me këtë.

Drejtori i Departamentit Administrativ dhe Departamentit Teknik janë koordinatori i riskut, i cili ka përgjegjësi për:

- i) bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njëjësive dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij;
- ii) këshillimin dhe dhënien e instruksioneve menaxherëve të tjerë të kompanisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Auditit të Brendshëm;
- iii) paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të njësisë publike të Administratori dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të kompanisë;
- iv) monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë që menaxhojnë.

Drejtorët e drejtorive, si menaxherë janë përgjegjës për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejojnë.

Menaxhimi i riskut është një proces në vazhdimësi, i cili duhet të jetë pjesë integrale e procesit të menaxhimit si i tërë dhe është përgjegjësi e të gjithë stafit.

7.3. Regjistri i Riskut

Regjistri i Riskut është dokumenti ku evidentohen të dhënat mbi risqet e identifikuar, seriozitetin e tyre dhe veprimet, hapat që do të merren për t'i adresuar ata respektivisht. Ai mund të jetë një dokument i thjeshtë ose një tabelë që paraqet të gjithë informacionet në vetëm disa faqe.

Regjistri ofron një kornizë në të cilën problemet që kërcënojnë aktivitetin/kompaninë janë

paraqitur dhe shoqëruar me veprimet adresuese për të reduktuar probabilitetin dhe ndikimin e mundshëm të risqeve të veçanta.

Elementët përbërës të Regjistrit të Riskut janë:

- Emri i institucionit;
- Përshkrimi i riskut;
- Niveli i riskut parakontrollit (ndikimi /propabiliteti)
- Kontrollat ekzistuese
- Risqet pas kontrolleve ekzistuese
- Nevoja për kontrolle të mëtejshme
- Veprime për të adresuar boshllëqet
- Zotëruesi i riskut

Modeli i Regjistrit të Riskut është si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i Riskut	Risku para Kontrollit (probabiliteti/impakti)	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevojat për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i riskut
1							
2							

7.4. Lista e objektivave kryesore të shoqëisë “Albpetrol” Sh.A,

Prioritetet kryesore për shoqërinë “Albpetrol” Sh.A, janë:

- ❖ Optimizimi i prodhimit të naftës dhe rritja e koeficientit të shfrytëzimit në vendburime;
- ❖ Rritja e numrit të puseve të rinj që i përkasin fondit “ndalur”;
- ❖ Vënia në efikasitet të plotë të puseve që nuk janë vënë në punë për shërbime të remonit nëntokësor (këmbim pompe, punime kompleti, etj.).
- ❖ Rritja e prodhimit të naftës përmes përmirësimit të teknologjisë së shfrytëzimit në vendburime, si rezultat i investimeve të programuara, kryesisht pomat PCP, pompat e thellësisë dhe aksesore të tjerë të puseve për naftë dhe gaz.
- ❖ Rehabilitimi i infrastrukturës sipërfaqësore në të gjithë vendburimet ku përfshihen: Infrastruktura transportuese e naftës (magjistrale apo tubacion pus-grup dhe grup- stacion; depozitat e magazinimit të naftës të të gjitha kapaciteteve (RVM nga 60m³ -1000m³)
- ❖ Rivitalizimi i stacioneve të shitjes të naftës brut sipas standardeve bashkëkohore;
- ❖ Implementimi i sistemeve të dixhitalizimit dhe monitorimit të puseve në vendburimet e Albpetrol dhe të aktivitetit të shoqërisë në përgjithësi për optimizimin dhe rritjen e performancës operationale dhe financiare;
- ❖ Minimizimi i humbjeve të naftës gjatë operacioneve të transportit nga stacionet e trajtimit (në magjistrale) si rrjedhojë e investimeve të parashikuara jo vetëm për ndërtimin e magjistrave por edhe dixhitalizimit përmes sensorëve.

- ❖ Përmirësimi i situatës mjedisore që do të vijë si rrjedhojë e investimeve në infrastrukturën sipërfaqësore.

VIII. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Çdo vit buxhetor, shoqëria “Albpetrol” Sh.A, harton dhe miraton planin e veprimit për ndërmarrjen e aktiviteteve të përcaktuara për minimizimin e risqeve të evidentuara si prioritare për njësinë publike. Në këtë plan përcaktohen aktivitetet që do të ndërmerren, njësia përgjegjëse që do t'i realizojë, si dhe afatet e realizimit.

Tabela ilustruese për planin e veprimit për zbatimin e strategjisë paraqitet si më poshtë:

Nr.	Aktiviteti	Strukturat përgjegjëse	Periudha e realizimit
1	Trajnimi i Drejtorëve të Drejtorive në fushën e menaxhimit të riskut	Drejtori i Departamentit Administrativ	Brenda muajit Maj 2024
2	Hartimi Regjistrir të riskut	Koordinatori riskut	Brenda muajit Maj 2025
3	Përmirësimi i Regjistrir të riskut	Koordinatori riskut	Brenda muajit Nëntor
4	Trajnimi i punonjësve të rinj për menaxhimin e riskut	Drejtorja e Financës dhe Juridike	Vazhdimisht